

Udhezues mbi Barkodet Nga GS1 Albania



Fillo ketu

GS1 është një organizatë që funksionon nepermjet anetaresimeve. Për të pajisur me barkode kompaninë tuaj duhet të jeni anetar i organizatës. Tarifa e regjistrimit për anetarët e rinj është fikse për çdo subjekt, paguhet vetëm një herë në momentin e regjistrimit dhe ka një vlerë prej ALL 15.000

Çfare duhet të beni?

Për të krijuar barkodet, ju duhet të pajiseni me një game ekskluzive numrash barkodi për kompaninë tuaj. Kjo bëhet e mundur nepermjet një leje përdorimi që rinovohet çdo vit. Ekzistojnë disa lloje lejesh përdorimi në varësi të numrit tuaj të produkteve.

Cila leje përdorimi është e duhura për mua?

GCP 11 – Kjo leje përdorimi është për prodhues apo artizanë të vegjël, të cilët nuk do kenë nevojë për më tepër se 10 barkode për produktet dhe kutitë e tyre.


GCP 10 – Nëse do ju duhen më tepër se 10 barkode gjatë jetës së biznesit tuaj atëherë një GCP 10 është më ekonomike. Kjo leje përdorimi ju mundëson që të krijoni deri në 100 barkode për produktet dhe kutitë. Nuk duhet të harroni se dhe kutitë e jashtme kanë nevojë të pajisen me barkode unike.

GCP 9 – Nepermjet kësaj leje përdorimi do të keni mundësinë të gjeneroni deri në 1,000 barkode për produktet tuaja.

Çfare ju duhet për të perfunduar regjistrimin?

Në mënyrë që aplikimi për regjistrim në GS1 Albania të kryhet sa më shpejt ju rekomandojmë që të keni pranë këto informacione:

1. Informacion për kompaninë (emri dhe adresa)
2. Informacion kontakti për Administratorin dhe 1 person tjetër (zakonisht financiar)
3. Nipti i kompanisë
4. Informacion mbi produktet



Hapi 1: Plotësoni aplikimin për regjistrim



Hapi 2: Pajisuni me Prefiksin GS1



Hapi 3: Gjeneroni barkodet me anë të prefiksit të kompanisë

Kryerja e pagesës së regjistrimit

Pagesa e regjistrimit në organizatën GS1 Albania mund të kryhet pranë zyres sonë ose me bankë:

BANKA: CREDINS

Emri i llogarisë: GS1 Albania
IBAN: AL 2721211205000000000374067
(për transfertat në Leke)

Lutemi deklaroni arsyen e pagesës si:
Pagesë Vjetore e Anetaresimit të Kompanisë në GS1 Albania.

Keni nevojë për ndihmë

Stafi jonë mund t'ju ndihmojë për çdo pyetje që mund të keni rreth barkodeve dhe Sistemit GS1. Na kontaktoni ne:

E: info@gs1al.org
T: +355 42 232 073

Perfitimet per biznesin tuaj

Unik

Ne saje te prefiksit GS1 ju keni te drejten e vetme per te perdorur gamen e numrave tuaj te barkodeve. Barkodi juaj eshte i lidhur vetem me biznesin tuaj dhe mund te identifikohet nepermjet numrit te barkodit.

I Verifikueshem

Nepermjet barkodit te lidhur me kompanine tuaj, marketet dhe distributoret mund te kontrollojne numrin e barkodit per te verifikuar pronesine. Kjo mund te jete e dobishme ne raste te heqjes nga tregu te produkteve ose per te ndihmuar ne zbulimin e produkteve te falsifikuara.

Gjurmueshmeri

Numri unik i barkodit ne produktin tuaj eshte nje element thellesor i sistemeve te gjurmueshmerise.

I Shkallezueshem

Numrat GS1 te identifikimit te produkteve formojne bazen e nje sere programesh qe mund te nevojiten per tu perdorur nga bizneset ne rritje si EDI dhe shkembimi dixhital i te dhenave.



Anetaresimi ne GS1 Albania

Ne jemi pjese e organizates globale GS1 e cila percakton standartet qe garantojne funksionimin e barkodeve ne çdo zinxhir furnizimi dhe ne çdo shtet te botes.

Dhe si nje organizate jo-fitim-prurese, punojme me anetaret tane per te zhvilluar vazhdimisht standartet tona - ne menyre qe te jene ne nje hap me ndryshimet ne mjedisin e biznesit dhe duke i ndihmuar qe te rrisin prezencen e tyre lokale dhe nderkombetare.

Industria Ushqimore

Nga Ferma ne Tavoline - barkodet GS1 mbeshtesin zinxhirin e furnizimit te industrise ushqimore.

Barkodet GS1 perdoren nga distributoret dhe operatoret kryesore te bizneseve ushqimore ne Shqiperi - duke reduktuar gabimet, permiresuar nivelet e stokut dhe reduktuar kostot.

Shitje Online

Nese keni ne plan te shisni online, do ju kerkohej te keni nje barkod, GTIN ose numer EAN. Kjo mund t'ju duket pak e frikshme ne fillim, por nese pajiseni me barkode nga GS1 Albania do te perfitoni nga suporti i eksperteve tane.

Numrat qe shihni poshte barkodeve jane identiteti unik i produkteve tuaja. Dhe ju do te keni nevojte per keto numra per shitjet online ne platformat tregtare si Amazon, eBay, etj.

Me ju ne çdo hap te rrugetimit tuaj

Nese biznesi juaj rritet, operacionet e tij do te behen me komplekse, dhe nevoja per te identifikuar, lexuar dhe shkëmbyer informacionin mbi produktet do te evoluojë gjithashtu. Ne kete pike, perdorimi i standarteve GS1 ne biznesin tuaj do te shkoje pertej perdorimit te barkodeve.

Shkembimi Elektronik i Te Dhenave (EDI) –

Nese volumi i biznesit tuaj rritet, ju mund te gjendeni ne nje situate ku njeri nga partneret tuaj tregtare perdor nje sistem automatik te porositjeve dhe faturimeve ose ndryshe sistem EDI ne vend qe te perdore dokumenta ne leter. Ne kete pike, GS1 do ju ndihmoje me mesazhet elektronike dhe do ju pajise me nje license per nje numer unik kutie-postare EDI te quajtur Numri Global i Vendndodhjes ose GLN.

Cilesia e Te Dhenave – Nderkohe qe biznesi juaj zgjerohet dhe fillon te perdore portale online te shkembimit te te dhenave, mund te jete momenti i duhur qe te fokusoheni ne cilesine e te dhenave. GS1 do ju ndihmoje qe te pergatisni te dhena te kompletuara, konsistente, te sakta dhe te perditesuara sic kerkohen nga standartet e ndryshme te industrise.

Gjurmueshmeria – A e dini se ju mund te perdorni standartet GS1 dhe zgjidhje te bazuara ne standarte per t’ju ndihmuar qe te permbushni rregullat nderkombetare per sigurine e produkteve dhe gjurmueshmerine. GS1 ju keshillon nese keni nevojte per ndihme mbi implementimin e gjurmueshmerise per biznesin tuaj.

Trajnime – Ne çdo faze te biznesit tuaj mund te kontaktoni me ne nese keni pyetje teknike rreth standarteve GS1 dhe zinxhirit te furnizimit. Nese eshte e nevojshme mund te perfitoni me teper nga trajnimet e ndryshme qe ofrojme.

